




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.553/2023

Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenit 7 dhe 34 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur me datë 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Miratohet Plani i përgjithshëm i personelit për gjyqtarë dhe administratën gjyqësore për vitin 2024, që përfshinë të gjitha nivelet e gjykatave / degëve, Sekretariatit e KGJK-së dhe Njësinë për Inspektim Gjyqësor;
- II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së, që të përgatis dhe të sjell për miratim në Këshill, planin për shpalljen e pozitave të lira për rekrutim, sipas planit të përgjithshëm të personelit sipas pikës I të vendimit;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është njoftuar me propozimin e Planit të përgjithshëm të personelit për gjyqtarë dhe administratën gjyqësore për vitin 2024 përfshirë këtu pozitat e Aprovuara, të plotësuara, të lira si dhe pozitat që do të shuhen dhe shndërrohen në pozita profesionale.

Këshilli, ka shqyrtuar dhe diskutuar lidhur me propozimin e paraqitur nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore rreth analizës sa i përket gjendjes aktuale në sistemin gjyqësor, nevojës për shtimin e numrit të punonjësve profesional dhe zvogëlimin e numrit të punonjësve teknik-mbështetës në gjykata. Po ashtu, Këshilli vlerësoj të dhënat e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore që konfirmojnë se zbatimi i këtij vendimi ndihmon në përmirësimin e performancës në përgjithësi dhe nuk paraqet vështirësi buxhetore.

Pas shqyrtimit të propozimit, Këshilli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe